

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE PRISHTINË-DEGA PODUJEVË-Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Penal, Gjyqtari i vetëm gjykues, Gazmend Bahtiri, me pjesëmarrjen e sekretares juridike Mihrie Sheholli, në çështjen penale kundër të akuzuarit A.H. nga P., rruga “...” pn, për shkak të veprës penale Rrezikim i trafikut publik nga neni 378 par.9 lidhur me par.6 të KPRK-së, sipas aktakuzës së PPQ në Prishtinë tani Prokurorisë Themelore në Prishtinë-Departamenti i Përgjithshëm, PP/II.nr.601-4/2012 dt.13.09.2012, pas mbajtjes së seancës së shqyrtimit fillestar me datë 04.06.2014, në praninë e Prokurorit të Shtetit Bukurie Gjonbalaj, të akuzuarit dhe mbrojtësit të tij sipas autorizimit Av. M. S. nga Prishtina, mori dhe publikisht shpalli këtë:

A K T G J Y K I M

I akuzuari:

A. H., i biri i K. dhe nënës Gj., e vajzërisë Rr., i lindur më dt. *data e lindjes...*, në P., me vendbanim në P., rruga “...” pn., me numër personal *numër personal...*, ka të kryer shkollën e mesme, punon në post private-biznes privat, i gjendjes së varfër ekonomike, i pa martuar, më parë i pa dënuar, kundër tij nuk zhvillohet procedurë tjetër penale, Shqiptar-Shtetas i Republikës së Kosovës, ka qëndruar në paraburgim prej datës 17.08.2012, e deri më datën 14.09.2012.

Ë S H T Ë F A J T O R

Sepse:

Me datë 17.08.2012, rreth orës 16:30, në Podujevë, rruga “Besnik Restelica” respektivisht derisa ishte duke qarkulluar nga drejtimi i rrugës “Zahir Pajaziti” në drejtim të rrugës “Ali Ajeti” me të arritur te udhëkryqi që lidhë rrugët “Besnik Restelica” me rrugën “Dardania”, automjeti Opel Korsa, me ngjyrë të kuqe, me targa *numër i targave...*, i cili ishte duke qarkulluar në shiritin e vet të lëvizjes të cilin e drjtonte i pandehuri, nga pakujdesia duke konsideruar me mendjelehtësi se deri tek aksidenti nuk do të vij, ka rrezikuar trafikun publik dhe ka vënë në rrezik jetën e njerëzve, duke mos ia përshtatur shpejtësinë e lëvizjes së automjetit kushteve ekzistuese të komunikacionit në kundërshtim me nenin 54.1 të Ligjit për sigurinë në komunikacionin rrugor, me pjesën e përparme të automjetit të tij e godet biçikletën në pjesën e prapme, e cila biçikletë ishte duke qarkulluar në drejtim dhe shirit të njëjtë, ku me rastin e goditjes biçikleta zvarritet në rrugë, ndërsa ngasësi i biçikletës me rastin e goditjes hedhet në pjesën e përparme të veturës në xhamin e përparmë (Parafango) e më pastaj nga automjeti në rrugë dhe me këtë rast biçiklisti-I. (O.) A. si pasojë e lëndimeve të rënda trupore-vdekjeprurëse ka ndërruar jetë pas pak çasteve.

-Me këtë ka kryer veprën penale rrezikimi i trafikut publik nga neni 378 par.9 lidhur me par.6 dhe par.1 të KPRK-së.

Andaj gjykata në kuptim të neneve 4,17,41,42,43,45, dhe nenit 378 par. 9 lidhur me par. 6 dhe par.1 të KPRK-së, si dhe në bazë të nenit 365 të KPPRK-së, e

G J Y K O N

I. Të akuzuarin A. (K.) H., me dënim me burg, ashtu që i shqipton dënim me burg në kohëzgjatje prej një (1) viti, të cilin do ta vuaj pasi aktgjykimi të merr formën e prerë.

II. Konform nenit 83 par.1 të KPRK-së,në dënimin e shqiptuar i llogaritet edhe koha e kaluar në paraburgim nga data **17.08.2012,deri më datën 14.09.2014.**

III. Detyrohet i akuzuari që në emër të shpenzimeve të procedurës penale të paguaj shumën aq sa bëhen sipas llogarisë përfundimtare të kësaj gjykate ndërsa në emër të shpenzimeve paushalle të paguaj shumën **prej 30€(tridhjetë/euro)**,brenda afatit prej 15 ditësh,pasi aktgjykimi të merr formën e prerë.

IV.Të dëmtuarit-familja e të ndjerit, për realizimin e kërkesës pasurore-juridike udhëzohen në kontestin e rregullt juridiko-civil.

A r s y e t i m

PPQ në Prishtinë - tani Prokuroria Themelore në Prishtinë-Departamenti i Përgjithshëm, ka ngritur Aktakuzën PP.nr.601-4/2012 dt.13.09.2012,kundër të akuzuarit A.H.nga P., për shkak të veprës penale rrezikim i trafikut publik nga neni 297 par. 5 lidhur me par. 3 dhe par. 1 të KPK-së.

Lidhur me këtë çështje penale gjykata mbajti seancën e shqyrtimit fillestar më dt. 04.06.2014, gjatë së cilës u dëgjjuan përfaqësuesi i Prokurorisë Themelore në Prishtinë, i akuzuari dhe mbrojtësi i tij.

Fillimisht para leximit të aktakuzës, Prokurori i shtetit deklaroi se e bën përmirësimin e aktakuzës sa i përket kualifikimit ku thuhet “kishte” duhet të jetë “me këtë ka kryer”, dhe bëri rikualifikimin e veprës penale bazuar në nenin 3 par 2 të KPRK-së, dhe nga vepra penale rrezikimi i trafikut publik nga neni 297 pa.5 lidhur me par 3 dhe par.1 të KPK-së, në vepër penale rrezikimi i trafikut publik nga neni 378 par.9 lidhur me par 6 dhe par.1 të KPRK-së.

I akuzuari në seancën e shqyrtimit fillestarë pas konsultimeve të mjaftueshme me mbrojtësin e tij Av.M. S. ka deklaruar se në tërësi e pranon fajësinë për të gjitha pikat e Aktakuzës për veprën penale Rrezikim i trafikut publik nga neni 378 par. 9 lidhur me par.

6 dhe par.1 të KPRK-së, dhe ka theksuar se ndien keqardhje për të ndjerin dhe familjen e tij, dhe shtoi se i kërkon falje familjarëve.

Prokurori i shtetit në seancën e shqyrtimit fillestarë lidhur me pranimin e fajësisë ka dhënë mendimin: Se pajtohet me pranimin e fajësisë të pandehurit, pranimi i fajësisë mbështetet në dispozitat e Kodit të Procedurës Penale të Republikës së Kosovës, dhe është në përputhshmëri me provat materiale që gjenden në shkresat e lëndës, dhe ka shtuar se mbetem pranë aktakuzës dhe i propozoj gjykatës që të njëjtin ta shpall fajtor dhe ta dënoj sipas ligjit.

Mbrojtësi i të akuzuarit në seancën e shqyrtimit fillestar lidhur me pranimin e fajësisë ka dhënë mendimin: Duke theksuar se pas konsultimit me të mbrojturin tim në asnjë moment nuk ka hezitur që ta pranoj fajësinë sipas aktakuzës për veprën penale që e ngarkon, ndien shumë keqardhje për atë që i ka ndodhur, me familjen e tij menjëherë i kanë kërkuar falje familjes së dëmtuar me çka ka rezultuar me pajtesën mes këtyre dy familjeve edhe me shkrim me datë 24.08.2012, kërkoj nga gjykata që me rastin e llojit dhe lartësisë së dënimit të ketë parasysh rrethanat lehtësuese sjelljen e të mbrojturit tim se para këtij rasti asnjëherë nuk ka rënë në kundërshtim me ligjin, të ketë parasysh faktin se pranimin e fajësisë e ka bërë pa hezitim, duke deklaruar para gjykatës se i vjen keq për atë që ka ndodhur, se asnjëherë nuk ka drejtuar më automjetet, dhe kërkoj që t'i shqiptohet një dënim sa më i butë dhe atë në minimumin e paraparë me ligj dhe atë se me një dënim me kusht do të arrin qëllimin e paraparë me ligj apo nëse gjykata shqipton dënim me burg efektiv të njëjtin t'ia zëvendësoj me dënim me gjobë konform nenit 47 të KPRK-së.

Gjyqtari i vetëm gjykues vërteton se i akuzuari e ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajësisë, pranimi i fajësisë u bë vullnetarisht nga i akuzuari, pranimi i fajësisë mbështetet në faktet e çështjes që i përmban aktakuza në materialet e prezantuara nga prokurori i shtetit dhe aktakuza nuk përmban asnjë shkelje ligjore apo gabime faktike.

Gjykata pas pranimit të fajësisë nga ana e të akuzuarit, si dhe marrjes së mendimit të palëve, respektivisht prokurorit të shtetit dhe mbrojtësit të akuzuarit si dhe provave që gjenden në shkresat e lëndës vërteton se janë përmbushur të gjitha kushtet ligjore të parapara sipas dispozitës së nenit 248 par. 1 të KPPRK-së, dhe e aprovoi pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarit në shqyrtimin fillestar, andaj gjykata konform nenit 248 par.4 të KPPRK-së, nuk ka zbatuar procedurën e provave por ka vazhduar me shqiptimin e dënimit.

Pasi që i akuzuari e pranoi fajësinë vullnetarisht, gjykata e vlerësoi dhe analizoi se pranimi i fajësisë ka mbështetje në mendimin dhe konstatimin e ekspertit ing.dip.S. Sh.,e datës 12.09.2012, i cili në mendimin e tij ka theksuar se aksidenti i komunikacionit ka ndodhur nga lëshimet e drejtuesit të automjetit Opel Corsa i cili gjatë lëvizjes me automjet nëpër zonë urbane ka zhvilluar shpejtësi rreth 70 [km/h] e cila shpejtësi është e pa përshtatshme në rrugë urbane (qytet), duke mos i kushtuar kujdes të duhur pjesëmarrësve të tjerë në komunikacion(biçikletës), dhe nuk ka i ka ndërmarr veprimet preventive për ta evituar aksidentin, po ashtu pranimi i fajësisë ka mbështetje në skicën e vendit të ngjarjes si dhe foto dokumentacionin i cili gjendet në shkresat e lëndës.

Përveç këtij konstatimi të kësaj gjendje faktike të pakontestueshme, pranimi i fajësisë ka mbështetje edhe në Raportin e Autopsisë, i ekspertit mjeko-ligjor Dr.A. G. i dt. 18.08.2012, se vdekja e të ndjerit I. O. A. ka ardhur si pasojë e gjakderdhjes në tru, nga veprimi i goditjes në komunikacion.

Në bazë të gjendjes faktike të vërtetuar edhe nga vet i akuzuari, gjykata vërteton se me veprimet inkriminuese të akuzuarit përmbushen të gjitha elementet qenësore të veprës penale Rrezikim i trafikut publik nga neni 378 par.9 lidhur me par.6 dhe par 1 të KPRK-së, e për çka gjykata gjeti se i akuzuari në aspektin penal-juridik është përgjegjës, ashtu që të njëjtin e shpalli fajtorë meqë veprën penale e ka kryer nga pakujdesia, andaj i shqiptoi dënim si në dispozitiv të aktgjykimit.

Me rastin e vendosjes së llojit dhe lartësisë së dënimit, gjykata pati parasysh të gjitha rrethanat e parapara me nenin 73 të KPRK-së, dhe në rastin konkret si rrethana lehtësuese gjeti vetëm faktin se i akuzuari A.H. gjatë shqyrtimit fillestar e ka pranuar në tërësi fajësinë për veprën penale e cila i vihet në barrë, gjykata ka vlerësuar faktin se i njëjti më parë kishte sjellje korrekte dhe nuk kishte rënë asnjëherë në konflikt me ligjin, dhe ndien shumë keqardhje për vdekjen e të ndjerit I. A., është i moshës së re, të gjitha këto rrethana kjo gjykatë i ka pranuar si rrethana lehtësuese në dobi të akuzuarit, duke e marrë parasysh shkallën e përgjegjësisë penale si rrethana veçanërisht rënduese gjykata gjeti dhe pati parasysh shkallën e përgjegjësisë penale të akuzuarit, intensitetin e rrezikimit apo dëmtimit të vlerës së mbrojtur në këtë çështje penal-juridike vlera e mbrojtur është jeta e njerëzve respektivisht kemi të bëjmë me humbjen e jetës së tani të ndjerit-I. A., rrethanë rënduese është fakti se i akuzuari nuk e ka respektuar shpejtësinë e lëvizjes në qytet, megjithëse e ka vërejtur biçiklistin dhe nuk i ka kushtuar kujdes të duhur dhe nuk ka ndërmarr veprime preventive për ta evituar aksidentin. Kjo veprë penale është shumë e shpeshtë në vendin tonë, vetëm për shkak të mos kujdesit të duhur ndaj këmbësoreve- biçikletave dhe mosrespektimit të rregullave të komunikacionit, andaj gjykata me shqiptimin e dënimit si në dispozitiv të aktgjykimit beson se ky dënim është në proporcion me peshën e veprës penale dhe me sjelljen dhe rrethanat e kryesit, dhe është adekuat me shkallën e rrezikshmërisë shoqërore të veprës së kryer penale dhe shkallën e përgjegjësisë penale të akuzuarit dhe se me një dënim të tillë do të arrihet qëllimi i dënimit i paraparë me nenin 41 të KPRK-së, që të parandaloj kryesin nga kryerja e veprave penale në të ardhmen të bëjë rehabilitimin e tij, dhe të parandaloj personat e tjerë nga kryerja e veprave ngjashme penale.

Vendimi mbi llogaritjen e paraburgimit në dënimin e shqiptuar u muar në kuptim të nenit 83 par.1 të KPRK-së.

Vendimi mbi udhëzimin e të dëmtuarve për realizimin e kërkesës pasurore-juridike në kontest civil është marrë në kuptim të nenit 463 par. 1 dhe 2 të KPRK-së.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale dhe paushallit gjyqësor u muar në bazë të nenit 450 par. 1 dhe 2 pika 2.1. dhe 2.6 lidhur me nenin 453 par. 1 të KPRK-së.

Nga sa u tha më lartë e në bazë të nenit 365 të KPPRK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij Aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE PRISHTINË-DEGA PODUJEVË
Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni penal
P.nr.907/13,dt.04.06.2014

Sekretare Juridike
Mihrie Sheholli

Gjyqtari i vetëm gjykues
Gazmend Bahtiri

KËSHILLA JURIDIKE:

Kundër këtij aktgjykimi mund të ushtrohet Ankesë në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimit të njëjtit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë e nëpërmes kësaj Gjykate.